

**1 VEND I LIRË PËR PUNONJËS ADMINISTRATIV( PUNONJËS MIRËMBAJTJE)**  
**NË GARDËN E REPUBLIKËS**

**I. KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJNË KANDIDATËT :**

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të mos jetë përjashtuar ose larguar nga puna për shkelje ligjore apo disiplinore;
- c) të jetë i aftë nga ana shëndetësore;
- ç) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundra vajtjeje penale me dashje;
- d) të mos jetë në ndjekje penale;
- dh) të mos i jetë hequr e drejta e ushtrimit të funksioneve në administratën publike me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Aplikanti që nuk plotëson qoftë edhe 1 nga kriteret e mësipërme, nuk kualifikohet dhe nuk duhet të vazhdojë aplikimin.

**II. DOKUMENTAT QË DUHET TË PARAQESIN KANDIDATËT:**

Aplikantët duhet të paraqesin në Sektorin e Burimeve Njerëzore dokumentet e mëposhtëme:

- a) kërkesë me shkrim;
- b) fotokopje të kartës së identitetit;
- c) certifikatë të gjendjes shëndetësore;
- ç) vërtetim gjyqësor;
- d) vërtetim prokurorie;
- dh) referenca për punët e kryera.
- e) dy foto (9 X 12) me këmishë dhe kollare.
- ë) fotokopje të librezës së punës

**Dokumentat do të dorëzohen dorazi nga aplikanti në adresën: Garda e Republikës, Rruga e Elbasanit, Pallati i Brigadave, Tiranë, brenda datës 26.05.2026.**

**III. SHQYRTIMI I DOKUMENTACIONIT DHE PROCESI I ANKIMIMIT**

- Afati i shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit është 3 ditë pune nga mbyllja e afatit të aplikimeve.
- Aplikanti, që nuk plotëson kriteret dhe nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar brenda afatit të aplikimit, skualifikohet.
- Aplikanti ka të drejtën e ankimit brenda 2 ditëve nga data e njoftimit të përgjigjes. Komisioni i apelimit shqyrton dhe kthen përgjigje brenda 2 ditëve nga data e marrjes së ankesës me telefon ose adresë e-mail.

**IV. TESTIMI I KANDIDATËVE**

Intervista dhe testi psikologjik, me kandidatët e kualifikuar në fazën e shqyrtimit të dokumenteve do të zhvillohet prej orës 08<sup>00</sup> deri në orën 12<sup>00</sup> të datës 28.05.2026, në adresën: Garda e Republikës, Rruga e Elbasanit, Pallati i Brigadave, Tiranë,

**V. NJOFTIMI I FITUESVE**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, kandidati fitues në këtë procedurë do të njoftohet individualisht në mënyrë elektronike (e-mail personal) ose me telefon nga Garda e Republikës